

VENDIM
Nr. 730, datë 3.12.2025

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 450, DATË 30.6.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MATERIALEVE DHE TË
PAJISJEVE SPORTIVE, QË PËRJASHTOHEM NGA DETYRIMET DOGANORE
DHE TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR, SI DHE PROCEDURA E PËRJASHTIMIT
TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 7, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën që i bashkëlidhet vendimit nr. 450, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe procedurat e përjashtimit të tyre”, bëhen këto shtesa:

- a) Pas pikës 39, të kreut VII, shtohen pikat 40 dhe 41, me këtë përmbajtje:
“40. Jelekë për monitorimin e performancës së lojtarëve;
41. Mbulesë fushe.”;
- b) Pas pikës 25, të kreut IX, shtohet pika 26, me këtë përmbajtje:
“26. Panele për trajnime dhe mure elastike për ushtrime.”;
- c) Pas pikës 7, të kreut XI, shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:
“8. Pajisje ndihmëse për ndërtimin e pistës së garave (matës të lartësisë, metrik për distancat, kone sinjalizuese, kronometër elektronik me sensorë).”;
- ç) Pas pikës 35, të kreut XVIII, shtohen pikat 36 dhe 37, me këtë përmbajtje:
“36. Matës shpejtësie për topat;
37. Ngjitës shirit për tarafleks.”;
- d) Pas pikës 9, të kreut XIX, shtohen pikat 10, 11 dhe 12, me këtë përmbajtje:
“10. Pajisje për ski me patina (*roller ski*);
11. Pajisje për ski në bar;
12. Pajisje dhe veshje për *snowboard*.”;
- dh) Pas pikës 23, të kreut XXII, shtohen pikat 24, 25, 26, 27 dhe 28, me këtë përmbajtje:
“24. Rrjeta për fusha tenisi profesionale dhe amatore;
25. Rrjeta fundore errësimi për fusha tenisi;
26. Shtresa të llojeve të ndryshme për shtrimin e fushave të tenisit;
27. Rezinë dhe akrilik të ndryshëm për shtimin dhe lyerjen e fushave të tenisit;
28. Aksesore të ndryshëm për fushat e tenisit (shtylla, makineta për tendosjen e rrjetave, shirita për mesin e rrjetës, pajisje për tharjen dhe pastrimin e fushave).”;
- e) Pas pikës 11, të kreut XXIII, shtohen pikat 12 dhe 13, me këtë përmbajtje:
“12. Robotë të dedikuar për mësimet e shahut;
13. CD dhe programe për mësimet e shahut.”;
- ë) Pas pikës 13, të kreut XXXVI, shtohen pikat 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21, me këtë përmbajtje:
“14. Polo/pantallona sportive;
15. Jelekë identifikues;
16. Kuti shahu;
17. Raketa ping-pongu;
18. Raketa tenisi;
19. Rrjeta për volejboll dhe *beachvolley*;
20. Shporta ose karroca për topat;

21. Shirit për shënimin e fushës.”;

f) Pas kreut XXXIX shtohen krerët XXXX, XXXXI, XXXXII dhe XXXXIII, me këtë përmbajtje:

“XXXX. ORGANIZATAT SPORTIVE TË ARTEVE MARCIALE MIKSE

1. Doreza për arte marciale mikse;
2. Doreza për boks;
3. Mbrojtëse për dhëmbë;
4. Mbrojtëse për kërcinjtë;
5. Mbështjellëse për duar;
6. Mbrojtëse intime për meshkuj;
7. Helmetë mbrojtëse;
8. Bluza, tuta dhe rroba për stërvitje;
9. Jastëkë për goditje me këmbë;
10. Mbrojtëse për goditje;
11. Jastëkë për *kickboxing*;
12. Thasë për goditje;
13. Mbrojtëse për bërryla;
14. Mbrojtëse për gjunjë;
15. Mbrojtëse për kyçin e dorës;
16. Mbrojtëse për kyçet e këmbëve;
17. Mbrojtëse për trupin;
18. Topa për stërvitje;
19. Shtanga;
20. Pesha për shtanga;
21. Kafaz oktagonal për ndeshje;
22. Ring për boks;
23. Dyshekë për stërvitje;
24. Çantë për pajisje;
25. Material për mbështjellje dhe ngjitje;
26. Këpucë për stërvitje.

XXXXI. ORGANIZATAT SPORTIVE TË PADELIT

1. Raketa padeli;
2. Topa padeli;
3. Veshje sportive për padel;
4. Këpucë specifike për padel;
5. Rrjeta padeli;
6. Shtylla për rrjeta padeli;
7. Fusha modulare për padel;
8. Sisteme ndriçimi për fushat e padelit;
9. Karkasa metalike dhe xhami sigurie për ndërtimin e fushave të padelit;
10. Sisteme mbrojtëse dhe rrjeta sigurie;
11. Pajisje për stërvitje dhe ushtrime teknike të padelit.

XXXXII. ORGANIZATAT SPORTIVE TË TRIATHLON-it

1. Veshmbathje dhe uniforma sportive (pantallonçina për çiklizëm, kostume neopren, këpucë sportive çiklizmi, fanella verore dhe dimërore për çiklizëm, tuta sportive e mushama mbrojtëse nga shiu, kaska mbrojtëse për çiklizëm, doreza sportive);

2. Syze noti;
3. Syze për çiklizëm;
4. Biçikletë profesionale;
5. Pjesë këmbimi për biçikletat.

XXXXIII. ORGANIZATAT SPORTIVE TË HARKUT

1. Pajisje për qitjen me hark (hark dhe pjesë të tij, shigjeta, aksesorë);
2. Pajisje mbrojtëse (mbrojtëse për gjoksin, mbrojtëse për parakrahun, mbrojtëse për

gishtin);

3. Pajisje shënjimi për harkun;
4. Teleskop i integruar për qitje precize;
5. Pajisje për kontrollin e largimit të shigjetës nga harku;
6. Letra me qarqe.”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama